



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 367/1Prot.

Tiranë, më 07 / 03 / 2019

V E N D I M

Nr. 38 , Datë 07 / 03 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.160, datë 09.10.2018, e një grupi personash¹, kundër subjektit privat, Bar “Sahati” Tiranë, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të orientimit seksual*”².

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, shprehen se me datë 28.09.2018, rreth orës 11:30 kanë shkuar tek Bar “Sahati” Tiranë. Ata citojnë se pasi kamarieri shërbeu kafetë, pas tij është paraqitur një zotëri, i cili u ka thënë që të mbarojnë kafetë dhe të mos shkojnë më tek ky lokal. Kur e kanë pyetur për arsyen se pse nuk duhet të shkonin më tek ky lokal, zotëria në mënyrë ironike dhe të përsëritur u ka thënë:“E dini vetë arsyen”, duke u lënë të kuptonin se arsyeja e vërtetë ishte për shkak të orientimit të tyre seksual.

¹ Subjektet ankues: A. A, K. M, A. H.

² Personat janë vetëdeklaruar si pjesë e komunitetit LGBTI.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në përfundim të ankesës së tyre, subjektet ankues kërkojnë konstatimin e diskriminimit të tyre për shkak të orientimit të tyre seksual, nga ana e punonjësit të Bar “Sahatit” si dhe gjobitjen e këtij subjekti.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1377/1 prot., datë 10.10.2018 i është kërkuar informacion subjektit Bar “Sahati” Tiranë, lidhur me pretendimin e subjekteve ankues.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Për shkak se nuk kishte asnjë përgjigje në adresë të KMD-së lidhur me sa mësipër, me shkresën me nr.1377/2 prot., datë 13.11.2018 Komisioneri, përmes një rikujtese i është drejtuar sërish Bar “Sahati” Tiranë, në mënyrë që të mund të paraqisnin parashtrimet e tyre lidhur me sa pretendohet nga subjektet ankues.

Me shkresën e datës 16.11.2018, protokolluar pranë KMD-së me nr.1377/5 prot., datë 19.11.2018, subjekti Bar “Sahati” Tiranë, lidhur me çështjen në fjalë parashtroi se: *“Jemi biznes privat. Ankuesve u kemi shërbyer për ditë me radhë, pa limit kohe. Koha e qëndrimit të tyre në lokal i ka kaluar normat. Në këto kushte nuk jemi të detyruar të pranojmë të bllokojmë punën tonë qoftë edhe nga keqkuptimet që mund të ndodhin, si në këtë rast”.*

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë së armëve për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri ka vlerësuar të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve.

Me shkresën me nr.1783 prot., datë 24.12.2018 Komisioneri ka njoftuar dhe ftuar palët për pjesëmarrje në seance degjimore, duke përcaktuar datën 08.01.2019.

Në seancë nuk u paraqit asnjëra nga palët. Referuar kuponit postar “Lajmërim marrje” me kod postar: RR 376 275 621 AA, rezulton se pala kundër së cilës është paraqitur ankesa, subjekti privat Bar “Sahati” Tiranë ka marrë dijeni për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohej seanca⁵. Subjektet të cilët kanë paraqitur ankesën nuk rezulton të kenë marrë dijeni për zhvillimin e seancës dëgjimore, pasi njoftimi është kthyer mbrapsht përmes shërbimit postar me shënimin “adresë e pasaktë” (është dërguar në adresën e shënuar në formularin e ankesës). Në këto kushte është njoftuar edhe përmes e-mailit të shënuar në formularin e ankesës⁶ (e-maili ndodhet në cilësi prove në dosjen e ankuesve), si dhe është telefonuar për t’u njoftuar dhe në rrugë telefonike por subjekti nuk është përgjigjur. Pra, nga ana e Komisionerit janë ezauruar të gjitha mjetet e kontaktimit me ankuesit, por ka qenë i pamundur komunikimi me ta.

4. Meqenëse asnjëra nga palët nuk u paraqit në seancë dëgjimore, dhe Komisioneri vlerësoi se për sqarimin e plotë të kësaj çështjeje nevojitej më shumë informacion, nëpërmjet shkresës me nr.159 prot., datë 30.01.2019 i është drejtuar sërish subjektit privat Bar “Sahati” Tiranë, duke kërkuar informacion dhe parashtrime shtesë.

⁶ Është shënuar e-maili i njërit nga subjektet ankues, si adresë kontakti.

Me datë 31.01.2019 pranë KMD-së është kthyer mbrapsht zarfi me shkresën drejtuar subjektit privat Bar “Sahati” Tiranë me shënimin “refuzon ta marrë”⁷.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesve se janë diskriminuar nga Bar “Sahati” Tiranë, për shkak të orientimit të tyre seksual.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri vlerëson se, Bar “Sahati” Tiranë ka dërguar një shkresë e cila, në pamje të parë “*a prima facie*” duket sikur e përmbush detyrimin për të dhënë informacion, por në thelb nuk i ka dhënë informacionin e kërkuar prej tij, duke mos i shërbyer kështu hetimit administrative me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të argumentuar në ligj për konstatimin ose jo të diskriminimit.

Për këtë shkak, Komisioneri, ftoi të dy palët në proces në një seancë dëgjimore, ku sejcila palë merr rol aktiv në parashtrimin dhe dokumentimin e pretendimeve të veta., gjë që nuk u mundësua për shkak të mos paraqitjes së tyre.

⁷ Referuar Kuponit postar me bar kodin: RR 948 967 849 AA.

Komisioneri konstaton se ankuesit pas dorëzimit të ankesës nuk kanë shfaqur asnjë interesim për të ndihmuar me informacion shtesë apo lidhur me mënyrën se si po procedohej me ankesën e tyre, dhe nuk është janë vënë në kontakt asnjëherë me strukturat e Komisionerit. Subjektet të cilët kanë paraqitur ankesën nuk rezultojnë të kenë marrë dijeni për zhvillimin e seancës dëgjimore, pasi njoftimi është kthyer mbrapsht përmes shërbimit postar me shënimin “adresë e pasaktë” (është dërguar në adresën e shënuar në formularin e ankesës). Në këto kushte është njoftuar edhe përmes e-mailit të shënuar në formularin e ankesës⁸ (e-maili ndodhet në cilësi prove në dosjen e ankuesve), si dhe është telefonuar për t’u njoftuar dhe në rrugë telefonike por subjekti nuk është përgjigjur. Pra, nga ana e Komisionerit janë ezauruar të gjitha mjetet e kontaktimit me ankuesit, por ka qenë i pamundur komunikimi me ta.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar dhe prova të tjera mund të merreshin kryesisht nga subjektet ankues, fakt i cili u bë pamundur për shkak të mos kontaktimit të tyre dhe interesimit të tyre për ecurinë e çështjes pranë KMD-së.

Për sa më sipër, u konstatua se, në nenin 94/4, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, parashikohet: “4. *Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin⁹ 91 të këtij Kodi”.*

Në përfundim, rezultojnë se gjatë shqyrtimit të ankesës së tyre, subjektet ankues kanë qenë inaktiv për më shumë se 4 muaj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 94/4, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenet 1, 3, 12/1, 21/1, neni 32/1, gërma a), nenin 33/10 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

⁸ Është shënuar e-maili i njërit nga subjektet ankues, si adresë kontakti.

⁹ Neni 91, pika 1 e Ligjit 44/2015, parashikon se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.*”

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr.160, datë 09.10.2018 të grupit të personave¹⁰, për shkak se ankuesit kanë braktisur çështjen.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Orientimi seksual

¹⁰ Subjektet ankues: A. A, K. M, A. H.

